



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KOMUNËS**

14-346/07-0245728/18 më 09 -10- 2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 17, paragrafi 6 i Ligjit nr. 04/L-179, për transportin rrugor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 21/13, qershor 2013), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

**V E N D I M**

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e linjave të transportit të rregullt urban dhe urban-periferik i udhëtarëve me autobus, në bazë të obligimeve që dalin nga Marrëveshja me BERZH-in, me ardhjen e 21 autobusëve të rinj.
- II. Linjat e caktuara si në pikën I të këtij vendimi, janë:
  - Linja "1": Prishtinë - Fushë-Kosovë, me itinerar: rr.: "Fadil Vata" (Fakulteti Teknik), "Afrim Zhitia", "Agim Ramadani", "UÇK", "Luan Haradinaj", "Bill Clinton", "Lidhja e Pejës", rruga rajonale dhe përfundon te Stacioni i Trenit në Fushë-Kosovë dhe anasjelltas.
  - Linja "3": Bardhosh, rruga rajonale Podujevë - Prishtinë, rr.: "Fahri Fazliu", "Mon Balaj", "UÇK", "Luan Haradinaj", "Garibaldi", "Gjorgj Bush", "Dëshmorët e Kombit", Rrethi i Flamurit, "Fehmi Lladroci", "Rruga e Çlirimit", "Muharrem Fejza", rrethi në Mat, "Enver Maloku", "Bahri Fazliu" (rruga "B"), "Xheladin Rekalii" dhe vazhdon anasjelltas për Sinidoll.
  - Linja "3C": Sinidoll, rr.: "Ibrahim Kelmendi", "Asllan Pireva", "Fahri Fazliu", "Ilir Konusheci", "Agim Ramadani", "Afrim Zhitia", "Fadil Vata", "Bahri Fazliu" (rruga "B"), "Enver Maloku", "Xheladin Rekalii" - "Agim Ramadani" dhe vazhdon drejt lagjes "Kodra e Trimave" për të përfunduar në rrugën "Ibrahim Kelmendi".
  - Linja Stacioni i Autobusëve: Kalabri, rr.: "Tahir Zajmi", "Fatime Sokoli", rruga magjistrale "M 2", "Ali Vitia", Rrethi i Flamurit, "Dëshmorët e Kombit", "Gjorgj



Bush", "Garibaldi", "Ukshin Hoti", "Robert Doll", "Bill Clinton" dhe Kalabri, Stacioni i Autobusëve.

- Linja Prishtinë - Keqekollë: rr.: "Ilir Konusheci", "Bajram Bahtiri", magjistralka "M 9", Llukar, Makoc, Grashticë, Stallovë, Keqekollë dhe anasjelltas.

III. Përgjegjës për mbajtjen e këtyre linjave është ndërmarrja publike lokale "Trafiku Urban".

IV. Ky vendim prodhon efekt juridik deri në momentin e zbatimit të Planit të mobilitetit.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**U dorëzohet:**

- NPL "Trafiku Urban",
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Shpend Ahmeti**